



UDHËZUESI PËR SHOQATAT SEKTORIALE (SHS)

SHËRBIMET E SHS NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN NË PANAIRIN TREGTAR

Publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara
Bonn and Eschborn, Germany
GIZ Office Kosovo
Rr. Arkitekt Karl Gega Nr. 38
10000 Pristina, Kosovo
T +383 38 233 002 100

E giz-kosovo-buero@giz.de
I www.giz.de/kosovo

Entrepreneurship Promotion Project

Dizajni

Envinion
Prishtine

Teksti

Florenta Mahmuti (D&D Business Support Center)
Juliane Lemcke
Klaus Goecke

Në emër të

Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Prishtina 2023

UDHËZUESI PËR SHOQATAT SEKTORIALE (SHS)

SHËRBIMET E SHS NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN NË PANAIRIN TREGTAR

Hyrje

Shoqatat nuk i ofrojnë shërbimet e tyre për treg të panjohur, por për anëtarët e tyre. Anëtarët janë anëtarësuar ose kanë themeluar shoqatë sepse presin që shoqata t'i plotësojë disa nevoja që ata nuk do të mund t'i realizonin vetë ose mund t'i bënin ato në një masë më të vogël. Në të njëjtën kohë, anëtarët janë anëtarët ata që përmes tarifave dhe kontributeve të tyre të anëtarësimit, si dhe punës së tyre vullnetare, duhet t'i sigurojnë shoqatës burime dhe kështu të krijojnë kapacitetin e saj. Rrjedhimisht anëtarët janë edhe mbështetës edhe klientë të shoqatës. Ky kontekst përcakton qëllimet e menaxhimit të shoqatës. Qëllimi nuk është maksimizimi i fitimeve, por është ofrimi i shërbimeve për anëtarët në mënyrë që ata të ruajnë anëtarësimin e tyre ose të tërheqin anëtarë të rinj. Në të njëjtën kohë, ofrimi i shërbimeve ekonomike shërben si burim të ardhurash për ta siguruar ekzistencën e shoqatës në plan afatgjatë.

Ky dokument do t'u sigurojë SHS-ve informacione mbi shërbimet që lidhen me pjesëmarrjen në panairët tregtare që mund të shtohen në portfolion e tyre të shërbimeve.

Përparësitë e pjesëmarrjes në Panaire Tregtare për SHS-të

SHS-të mund të marrin pjesë në panairë tregtare

- si vizitorë
- si pjesëmarrës në panair me standë për ta prezantuar vetë SHS -në
- së bashku me anëtarët e tyre në formë delegacioni
- së bashku me anëtarët e tyre si ekspozues


SHS -të mund të përfitojnë nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë duke

- Mbledhë informacione në lidhje me inovacionin, trendët e zhvillimit teknik dhe teknologjik brenda sektorit
- Mbledhë informacione mbi trendët e tregut vendor dhe ndërkombëtar për sektorin përkatës
- Krijuar bashkëpunime dhe partneritete me organizata të ngjashme nga vende të tjera
- Prezantuar produktet ose shërbimet e vetë SHS-ve
- Zgjeruar anëtarësinë
- Gjetja e frymëzimit dhe ideve se si t'i përmirësojnë shërbimet e veta për anëtarët e tyre
- Rritur të hyrat dhe qëndrueshmërinë e organizatës përmes zgjerimit dhe avancimit të shërbimeve

Shërbimet e Pjesëmarrjes në Panairin Tregtar

Shërbimet e Pjesëmarrjes në Panairin Tregtar mund të ndahen në 3 shtylla

1 Shërbimet Inteligjente të Panairit Tregtar



Mund të dallohen tri lloje të ndryshme të Shërbimeve Inteligjente të Panairit Tregtar. Shërbimi a), b) dhe c) janë të natyrës së përgjithshme dhe përfshijnë dhënien dhe mbledhjen e informacionit mbi sektorin, të dhënat e tregut dhe detajet e panairit tregtar, si dhe transferimin e njohurive rreth pjesëmarrjes në panair – nga vendimi për pjesëmarrje deri në fillimin e saj. Këto shërbime ose mund të përfshihen në tarifën vjetore të anëtarësisë ose mund të paguhet si tarifë e veçantë vetëm për ata anëtarë të interesuar për pjesëmarrje në panairin tregtar. Shërbimi i Konsultimit nën d) është shërbim i personalizuar dhe u ofrohet kompanive anëtare që kanë nevojë për mbështetje dhe këshilla të veçanta në formë personale dhe të përshtatur/personalizuara.



a) Informacioni

- Informacion për tregun specifik për sektorin
- Informacion mbi ekspozitat tregtare dhe ngjarjet në këtë sektor (p.sh., kombëtare/ndërkombëtare, lloji, profilet/numrat e ekspozuesve/vizitorëve, tarifatat e pjesëmarrjes, kushtet)



b) Transferimi i njohurive

- Udhëzues për pjesëmarrje në panairin tregtar
- Trajnime + Punëtori i panairit tregtar (p.sh., organizimi i panairit tregtar, përgatitja, Pika unike e shitjes (USP), hapat e shitjeve, mbledhja e të dhënave, veprimet përcjellëse, vlerësimi)



c) Udhëtime studimore të Panairit Tregtar

- Organizimi dhe shoqërimi në udhëtime studimore për grupe anëtarësh në kuadër të vizitave të panairëve specifike tregtare
- Mbledhja dhe vlerësimi i informacionit në terren




d) Konsultimi përgatitor

- Konsultimi përgatitor
- Mbështetje në zgjedhjen e panairit të përshtatshëm për profilin/produktin e anëtarit
- Ndihmë me planifikimin e projektit të panairit tregtar
- Ofrimi i kontakteve për shërbime të panairit
- Informacion mbi financimin e mundshëm të panairëve tregtare
- Udhëzime për organizimin: nga aplikimi për hapësirë deri në pjesëmarrjen përfundimtare

2


Shërbimi i Pjesëmarrjes në Panairin Tregtar – Pjesëmarrja në Grup

Kabinat e përbashkëta të panairit tregtar (p.sh., SHS-të ose shtete-pavijone) u mundësojnë NMVM-ve të kenë qasje në tregje të reja. Me kosto të ulëta investimi, kompanitë mund ta analizojnë konkurrencën dhe të krijojnë kontakte të reja. Ofrimi i Shërbimeve të Pjesëmarrjes në Panair Tregtar mund të shërbejë si burim për gjenerimin e të ardhurave dhe mbledhjen e informacionit (p.sh., të dhënat e tregut, kontaktet) për SHS-të; megjithatë, organizimi i pjesëmarrjes së suksesshme në panairin tregtar me standë të përbashkët kërkon njohuri, përvojë dhe përgatitje. Aktivitetet në lidhje me shërbimet e pjesëmarrjes ndahen në tri kategori shërbimesh 'organizim', 'lehtësim' dhe 'përcjellje', të cilat mund të tarifohen individualisht ose së bashku si paketë e plotë e panairit tregtar. Këto shërbime nuk do të përfshiheshin në tarifën e anëtarësisë, por do të faturoheshin si tarifë e bazuar në projekt.

**a) Shërbimi organizativ**

- Analiza e panairit dhe përzgjedhja e ekspozitës
- Vendimi për pjesëmarrjen kolektive
- Përzgjedhja e ekspozuesve dhe marrja
- Përpilimi i dokumentacionit të projektit
- Sigurimi i informacionit
- Bashkëpunimi dhe kontraktimi me organizatorin e panairit tregtar
- Rregullimi i standave për pjesëmarrësit
- Regjistrimi i bashkë-ekspozuesve

- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit
- Eksplorimi i mundësive të financimit
- Planifikimi dhe menaxhimi i projektit
- Administrimi (p.sh., tatimet, sigurimet)
- Strategjia, koncepti dhe komunikimi i pavijonit
- Projektimi dhe ndërtimi i pavijoneve
- Transporti dhe logjistika
- Materiali i përbashkët i marketingut
- Fushata promovuese para ekspozitës

**b) Shërbimi i lehtësimit**

- Ndihma në vendosjen e qëllimeve
- Ndihma në përgatitjen e buxhetit
- Sigurimi i informacionit dhe rrjetit të kontakteve (p.sh., ndërtues të standave, agjenci të dizajnit grafik dhe marketingut, kompani transporti, dogana)
- Asistencë me listat dalëse (vizita në stenda të tjera)
- Asistencë në udhëtime dhe rezervime hotelesh
- Asistencë me aplikimet për viza
- Ndihma në përgatitjen e ftesave dhe listave të adresave
- Ndihma në përgatitjen e materialit promovues
- Këshilla për transportin e ekspozitave


- Këshilla për pajisjen e hapësirës së standave
- Këshilla për zgjedhjen e produkteve
- Këshilla për prezantimin e ekspozitave
- Informacion mbi vendndodhjen (qytet, vizita, ambientet e panairit tregtar, etj.)
- Sigurimi i mjeteve të panairit tregtar (p.sh., lista kontrolli, fletë kontakti/shablone digjitale, video)
- Trajnimi i ekspozuesve para panairit (i gjithë stafi që është në panair)
- Menaxhimi i standave
- Reklamimi dhe marrëdhëniet me media (p.sh. organizimi i konferencave për shtyp)
- Organizimi i vizitave të delegacionit me program shoqëruar
- Organizimi i takimeve dhe ngjarjeve B2B me blerësit

c) Shërbimi i veprimeve përcjellëse

- Mbledhja e informacionit dhe mbledhja e të dhënave
- Digjitalizimi i informacionit (p.sh. fletët e kontaktit)

- Përgjigja 'aty për aty' për vizitorët e standës
- Ekzaminimi dhe vlerësimi i kontakteve
- Këshilla
- Raporti i rezultateve/Kthimi në investim
- Monitorimi i aktiviteteve dhe buxheteve

3 Organizimi i ngjarjeve të lidhura me sektorin nga vetë SHS-të



Ekzistojnë shumë mënyra me anë të të cilave SHS-të mund të organizojnë ngjarje të lidhura me sektorin, dhe ato radhiten më poshtë. Organizimi i një panairi tregtar është aktivitet shumë kërkuar, kompleks dhe i kushtueshëm. Qëllimi dhe kapaciteti janë faktorët kryesorë në vendimin për llojin dhe shkallën e një ngjarjeje. Në mesin e motiveve të ndryshme për një projekt panairi tregtar përfshihen gjenerimi i të ardhurave, promovimi i anëtarësimit, ngritja e profilit ndërkombëtar të një shoqate, zgjerimi i rrjetit të saj për iniciativa të përbashkëta dhe pozicionimi si bashkëbisedues me agjencitë ndërkombëtare të bashkëpunimit teknik për financimin e projekteve. Panairi tregtar është kryesisht mjet për promovimin e tregtisë dhe zhvillimin ekonomik për vendin pritës.

Duke pasur parasysh se sa kompleks është organizimi i tij dhe investimin e konsiderueshëm të kërkuar, ia vlen të shikohet se a mund të arrihen të njëjtat rezultate me mjete të tjera. E përbashkëta e të gjitha ngjarjeve është objektivi për ta bërë të njohur kapacitetin e furnizimit të sektorit për botën e jashtme dhe për ta lehtësuar zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit.

Përpara se të merret një vendim lidhur me organizimin e një panairi, është e rëndësishme të kuptohet se nga çka ndikohet vendimi i ekspozuesve dhe vizitorëve për të marrë pjesë, nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Suksesi ose dështimi i ngjarjes varet nga kjo. Një panair tregtar mund të jetë diçka shumë fitimprurëse, të paktën në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, në rast se arrin të pozicionohet fuqishëm në tregun global të ekspozitës dhe të realizojë tepriçë të ardhurash që mbulon investimin dhe që sjell fitim. Të organizosh panair tregtar do të thotë të sjellësh në treg një shërbim që tashmë është gjerësisht në dispozicion. Prandaj pyetja është se çfarë e bën tërheqës një panair të ri tregtar, d.m.th, cilat veçori e dallojnë atë nga të tjerët dhe tërheqin interesin e pjesëmarrësve të cilët e dinë se pjesëmarrja mund të jetë mjaft e kushtueshme dhe që natyrisht presin kthim nga investimi i tyre.¹

Llojet e ngjarjeve që SHS-të mund t'i organizojnë për sektorët që përfaqësojnë

- a) Tryeza të rumbullakëta, konferenca, ditë sektori
- b) Panair / mision shitjeje
- c) Panairi i konferencave (panairi i vogël tregtar që shoqëron konferencat dhe seminarët)
- d) Panairi vendore (ku ftohen vizitorë nga jashtë)
- e) Panairi ndërkombëtar tregtar

¹ Teksti (i ndryshuar) i marrë nga publikimi 'Basics for organizing trade fairs' (shqip: Bazat e organizimit të panairëve tregtarë) në faqen e internetit të Exhibition Center and Market Development Enterprise (ECMDE) of Addis Ababa, vizituar më 27.10.22 <https://aaexhibitioncenter.com/sites/default/files/pdf/BASICS-FOR-ORGANIZING-TRADE-FAIRS.pdf>



Gjenerimi i të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve rreth pjesëmarrjes në panairët tregtare

Në përgjithësi, të gjitha shërbimet e ofruara nga SHS për kompanitë anëtare duhet të vlerësohen dhe të shpërblehen. Sa më shumë që SHS investon në ofrimin e shërbimeve të detajuara si informacioni ose asistenca praktike në panairin përmes seminareve dhe trajnimeve, aq më shumë lind nevoja për burime të mjaftueshme për t'u paguar. Mund të realizohet një model me çmime modulare për paketa të ndryshme shërbimi dhe një ofertë shërbimi të plotë me zbritje.

Kontrolli i vlerësimit për SHS-të

Në tabelën në vijim mund të gjeni vetëvlerësim të shkurtër për SHS-të. SHS-të duhet t'u përgjigjen pyetjeve për t'i vlerësuar kapacitetet e tyre specifike në lidhje me pjesëmarrjen dhe organizimin e panairit tregtar

Ju lutemi tregoni nivelin tuaj të njohurive / shërbimit duke vendosur një 'X' në një nga 9 fushat	Kemi njohuri shumë të mira	Kemi njohuri	Ndihma nga jashtë do të ishte e mirë									
I njohim shumë mirë sektorët përkatës të industrisë sonë, akterët evropianë/ndërkombëtarë, ngjarjet dhe shtytësit specifike të sektorit. Mund të japim informacione thelbësore dhe të dobishme për kompanitë e tona anëtare	<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>			
Kemi marrë pjesë në shumë të tilla dhe kemi organizuar pjesëmarrje në disa panairë ndërkombëtarë si dhe mund t'i udhëzojmë kompanitë e tona anëtare në planet e tyre të vetme ose të përbashkëta për ekspozita	<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>			
Kemi njohuri dhe materiale për të mbajtur punëtori përgatitore për pjesëmarrje në panair tregtar	<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				<table border="1"><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>			

Një mundësi për strukturën e tarifave do të ishte ndarja e anëtarëve në dy grupe, p.sh.,

- Anëtarësimi bazik, ku anëtarët marrin vetëm shërbimet bazike me normë të ulët kontributi (pa informacionet e panairit si përfitim), dhe
- Anëtarësimi premium, ku anëtarët e kësaj kategorie marrin përfitime shtesë, në këtë rast edhe shërbimet e panairit, përveç përfitimeve të tjera, dhe paguajnë norma më të larta kontributi për këtë.

Duhet përmendur se me ofertë të shtuar të shërbimeve duhet të rritet edhe cilësia e shërbimeve.

Ju lutemi tregoni nivelin tuaj të njohurive / shërbimit duke vendosur një 'X' në një nga 9 fushat

Kemi njohuri shumë të mira

Kemi njohuri

Ndihma nga jashtë do të ishte e mirë

Kemi rrjet evropian. Jemi të lidhur mirë me organizatat përkatëse të panairove tregtare dhe mund t'u ofrojmë kompanive tona anëtare paketë shërbimi të plotë për pjesëmarrje në panairin tregtar

--	--	--	--

--	--	--	--

--	--	--	--

Kemi përvojë në panairin ndërkombëtar dhe mund t'i mbështesim kompanitë ekspozuese me prezantimet e tyre, si dhe me identifikimin e klientëve potencialë dhe përcjelljen

--	--	--	--

--	--	--	--

--	--	--	--

Kemi njohuritë dhe përvojën për të organizuar panairin tregtar vendor në industrinë time ose prezantime të panairove së bashku me kompanitë anëtare në tregjet ndërkombëtare / evropiane

--	--	--	--

--	--	--	--

--	--	--	--

Kemi krijuar bazë të të dhënave të kontakteve ndërkombëtare / evropiane që do të ftohen për t'u bashkuar me ngjarjet që organizojmë

--	--	--	--

--	--	--	--

--	--	--	--

